

MINISTRIA E DREJTËSISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PËRMBARIMIT
ZYRA PËRMBARIMORE KURBIN

Nr.2258Prot.

Laç, me 23.04.2019

V E N D I M - S H P A L L J E

(Lidhur me ekzekutimin e "Urdherit te Ekzekutimit" te titullit ekzekutiv te debitorit)

Ne Lac, sot me date 23.04.2019

Une, Rovena Prenga ,me detyre Permbarues Gjyqesore prane Zyres Permbarimore Kurbin, pasi studiova aktet proceduriale te ceshtjes permbarimore Nr.447 rregj. te vitit 2019 bazuar ne Urdherin e ekzekutimit Nr. -- prot Dt 04.03.2019 te Prokuroria e Rrethit Gjyqesor Kurbin ,

KONSTATOVA:

Se ne date 19.03.2019 eshte depozituar prane Zyres se Permbarimit kerkesa e kreditorit Prokuroria e Rrethit Gjyqesor Kurbin se bashku me "Urdherin e Ekzekutimit" Nr. -- date 04.03.2019 te Titullit Ekzekutiv (vendim gjyqesor) nr.214-14 te dates 01.02.2018, te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Kurbin, i cili eshte lene ne fuqi nga Gjykata e Apelit Tirane me vendim Nr.2475 te dt.21.11.2018,me pale dhe objekt:

- Kreditor: Prokuroria e Rrethit Gjyqesor Kurbin.
- Debitor: Enrik (Elton) Dod Mamli I dtl.11.05.1987 me banim ne Zheje.
- Me objekt: Pagim shpenzime proceduriale, konkretisht vleren monetare 97.000 leke + 11.640 leke per TFP dhe TVSh-ne mbi kete tarife, gjithsej 108.640 leke.

Nga ana e zyre tone permbarimore kane filluar procedurat ne baze te nenit 515 e vijues te K.Pr.Civile si dhe ligjit 8730 date 18/01/2001"Per Organizimin dhe Funksonimin e Sherbimit Permbarimor Gjyqesor"i ndryshuar per ekzekutimin e detyrueshem te Titullit Ekzekutiv te sipercituar.

Nga verifikimi i kryer nga ana jone ne bashkepunim me organet kompetente rezulton se debitori Enrik (Elton) Dod Mamli nuk ka marre dijeni nepermjet sherbimit postar, si rezultat I kesaj bazuar ne nenin 133/a ,133/b dhe 144/a si dhe 517 te K.Pr.Civile duhet te behet njoftimi me shpallje publike I debitorit lidhur me detyrimin qe ai ka ndaj pales kreditore Prokuroria e Rrethit Gjyqesor Kurbin per shpenzime proceduriale ne vleren 97.000 leke + 11.640 leke per TFP dhe TVSh-ne mbi kete tarife, gjithsej 108.640 leke.

Sa me siper ne mbeshtetje te Nenit 133/a ,133/b dhe 144/a si dhe 517 te Kodit Procedures Civile, ligjit Nr.8730 date 18/01/2001"Per Organizimin dhe Funksonimin e Sherbimit Permbarimor Gjyqesor",i ndryshuar

V E N D O S A

1-Te kryej njoftimin nepermjet shpalljes publike me afat 20 (njetzet) ditor (duke mare parasysh edhe komunikimin postar) nga data 23.04.2019 – 12.05.2019 te debitorit; Enrik (Elton) Dod Mamli I dtl.11.05.1987 me banim ne Zheje.

2-Ky vendim perpilohet ne disa kopje,ku nje kopje afishohet ne vendbanimin e fundit te pales debitore,nje kopje afishohet ne kendin e njoftimeve te kesaj zyre, nje kopje dergohet per afishim ne ambjentet e Bashkise Kurbin,nje kopje dergohet per afishim ne ambjentet e Gjykates se Rrethit Gjyqesor Kurbin dhe nje kopje i dergohet per publikim ne faqen zyrtare te Drejtorise se Pergjithshme te Permbarimit Tirane.

3-Kjo shpallje publike ka vleren e aktit te njoftimit per palen debitore; Enrik (Elton) Dod Mamli I dtl.11.05.1987 me banim ne Zheje.

4-Pala debitore Enrik (Elton) Dod Mamli I dtl.11.05.1987 me banim ne Zheje,duhet te paraqitet prane Zyres Permbarimore Kurbin me seli ne Lgj nr.4,Lac ne katin e pare ne ambjentet e Gjykates se Rrethit Gjyqesor Kurbin dhe te marre kontakt me permbaruesin gjyqesor te ceshtjes permbarimore per t'iu vene ne dispozicion aktet permbarimore,pasi me kalimin e ketij afati do te vijohet me ekzekutimin e detyruar sipas parashikimeve te nenit 519 e ne vijim te K.Pr.Civile

U shpall,sot me date 23.04.2019.

**PERMBARUES GJYQESOR
ROVENA PRENGA**

